



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA KUSHTETUESE  
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. regjistri 58/2021 (JR)  
Datë 11.10.2021

Vendim nr. 14 (JR)  
Datë 16.05.2022

**VENDIM**  
**NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

<b>Sokol Çomo</b>	<b>Kryesues</b>
<b>Rezarta Schuetz</b>	<b>Relatore</b>
<b>Albana Shtylla</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Ina Rama</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Mimoza Tasi</b>	<b>Anëtare</b>

- mori në shqyrtim më datë 16.05.2022, ora 14:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Tonçi Petković, me Sekretare Gjyqësore Adelajda Hiska, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit, që i përket:

**ANKUES:** Komisioneri Publik Darjel Sina.

**OBJEKTI:** Shqyrtimi i vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 410, datë 30.06.2021, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Atalanta Zeqiraj.

**BAZA LIGJORE:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës; neni C, pika 2, neni F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës; neni 63 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

**Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,**

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore publike, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), dëgjoi Komisioneren Publike Irena Nino<sup>1</sup> që kërkoi përfundimisht lënien në fuqi të vendimit të Komisionit të Pavarur të

<sup>1</sup> Znj. Irena Nino, e zgjedhur Komisionere Publike, në bazë të aktit të nxjerrë nga Kryetarja e Kuvendit të Shqipërisë, zëvendësoi ish-Komisionerin Publik ushtrues të ankimit, z. Darjel Sina.

Kualifikimit nr. 410, datë 30.06.2021, dëgjoi subjektin e rivlerësimit, znj. Atalanta Zeqiraj, mbrojtur në gjykim nga avokatja Romina Zano, e cila kërkoi përfundimisht lënien në fuqi të vendimit objekt shqyrtimi, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes Rezarta Schuetz, si dhe pasi e bisedoi atë,

## VËREN:

### I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Atalanta Zeqiraj, me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 84/2016, ushtronte funksionin e gjyqtares në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, iu nënshtua procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*.
2. Subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dërguar pranë institucioneve kompetente dhe brenda afatit ligjor përkatësisht deklaratën e pasurisë, deklaratën për kontrollin e figurës, si dhe formularin për vetëvlerësimin profesional, në përputhje me nenet 31, pika 1, 35, pika 1 dhe 41, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.
3. Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, znj. Atalanta Zeqiraj, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, dërgoi pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, duke konstatuar se:
  - (i) *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin, ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor;*
  - (ii) *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
  - (iii) *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
  - (iv) *nuk ka kryer deklaram të rremë;*
  - (v) *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*
4. Drejtorja e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja i ka përcjellë Komisionit raportin për subjektin e rivlerësimit, në përfundim të të cilit ka konstatuar përshtatshmërinë e vazhdimin të detyrës së subjektit të rivlerësimit, znj. Atalanta Zeqiraj.
5. Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim “KLGj”) ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për të dhënat e rezultuara nga tri dokumentet ligjore të përzgjedhura nga subjekti, pesë dokumentet ligjore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor,

të dhënat arkivore të KLGj-së, si dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar me nr. {\*\*\*} prot., datë 22.9.2020, për subjektin e rivlerësimit, dërguar në Komision me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 20.10.2020.

6. Bazuar në nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara për subjektin e rivlerësimit nga ILDKPKI-ja, DSIK-ja dhe KLGj-ja, Komisioni kreu procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin në fjalë, bazuar në të tria kriteret e vlerësimit (vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale), duke marrë vendimin nr. 410, datë 30.06.2021.

## **II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit**

7. Me vendimin nr. 410, datë 30.06.2021, Komisioni vendosi konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit. Mbi bazën e tri kriterëve të rivlerësimit, Komisioni ka konkluduar se:

7.1. Për kriterin e vlerësimit të pasurisë, subjekti i rivlerësimit, znj. Atalanta Zeqiraj, ka kryer deklaram të mjaftueshëm dhe të saktë të pasurive dhe interesave privatë, si dhe ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së saj në pronësi dhe përdorim. Subjekti nuk është përpjekur të fshehtë dhe të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi apo përdorim. Komisioni vlerësoi se subjekti i rivlerësimit justifikon plotësisht me burime të ligjshme krijimin e pasurive dhe shpenzimet përgjatë gjithë periudhës që ka ushtruar funksionin si gjyqtare.

7.2. Për kriterin e kontrollit të figurës, hetimi administrativ nuk konstatoi kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar dhe deklaramet e subjektit të rivlerësimit rezultuan të sakta dhe të vërteta. Komisioni vlerësoi se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

7.3. Për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, Komisioni arriti në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues.

## **III. Shkaqet e ankimit**

8. Komisioneri Publik (në vijim “Komisioneri”) ka paraqitur ankim kundër vendimit të Komisionit nr. 410, datë 30.06.2021, protokolluar pranë Komisionit me nr. {\*\*\*} prot., datë 30.09.2021. Në vlerësimin e Komisionerit Publik, vendimi objekt shqyrtimi përmban shkaqe të mjaftueshme ligjore për t’iu nënshtruar kontrollit të Kolegjit nëpërmjet ankimit. Komisioneri Publik fillimisht kërkoi që në përfundim të gjykimit të çështjes, të vendosej: (a) lënia në fuqi e vendimit objekt shqyrtimi të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit ose (b) ndryshimi i vendimit.

Në mënyrë të përmbledhur, shkaqet e ankimit të Komisionerit paraqiten si më poshtë.

8.1. Nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni për kriterin e pasurisë, kanë rezultuar problematika të njëjta të cilat lidhen me kontrollin e ligjshmërisë së burimit të të ardhurave të personit tjetër të lidhur – babait të subjektit të rivlerësimit – për dy apartamente në pronësi të tij, që janë përdorur apo vijnë të përdoren prej subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të, si dhe për burimin e financimit për blerjen e një automjeti në pronësi të personit të lidhur dhe dhuratat në vlerën 200.000 lekë.

**8.2.** Sipas Komisionerit, në vlerësimin e pasurive në përdorim dhe posedim të subjektit të rivlerësimit, Komisioni është mjaftuar me verifikimin e kapacitetit financiar të personit tjetër të lidhur, babait, duke arsyetuar se nuk rezulton të ketë pasur shmangie nga detyrimet tatimore, pavarësisht se përfitimi i shumave të përdorura për blerjen e pasurive nuk ka qenë rrjedhojë e shpërndarjes së fitimit (dividendit) në fund të vitit përkatës, duke mbetur të paprovuara plotësisht kërkesat kumulative të nenit D, pika 3 e Kushtetutës.

**8.3.** Komisioni ka konstatuar edhe situatën e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej subjekti i rivlerësimit në ushtrimin e detyrës, ndërlidhur me aktivitetin privat të personit të lidhur – të atit të saj – nën dritën e dispozitave të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar (në vijim “ligji nr.9367”), duke vlerësuar se qenia e babait të subjektit në kushtet e konfliktit të interesit, nuk mund të kualifikojë subjektin e rivlerësimit në kushtet e pamjaftueshmërisë në deklarinimin e kriterit pasuror dhe të përbëjë shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit të subjektit të rivlerësimit nga detyra.

**8.4.** Duke pasur në vëmendje mangësitë dhe natyrën specifike që paraqet rasti, lidhur me interesat privatë të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit, Komisioneri ka paraqitur si çështje për shqyrtim dhe kontroll të Kolegjit, vlerësimin nëse situatat faktike si më sipër, përlligjin përfundimet e arritura nga Komisioni për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, për qëllim të procesit të rivlerësimit, nenit 179/b, pika 1 e Kushtetutës, lidhur me kërkesat e nenit D/3 të Aneksit të Kushtetutës. Të ardhurat e krijuara për blerjen e pasurive në përdorim të subjektit nuk janë krijuar nëpërmjet shpërndarjes së fitimit (dividendit) në fund të vitit përkatës dhe, për pasojë, ky veprim përbën një shmangie nga detyrimet tatimore.

**8.5.** Në analizë të provave të administruara, Komisioneri vlerëson se përfundimi i arritur nga Komisioni nuk mund të konfirmohet si i drejtë dhe i bazuar. Nisur nga përmbajtja e arsytimit të këtij vendimi, ngrihen disa çështje për zgjidhje dhe orientim, të cilat mund të kenë rëndësi edhe për njësimin dhe vlerësimin e rasteve të ngjashme. Për këtë arsye, Komisioneri vlerëson të nevojshme që shqyrtimi dhe zgjidhja e këtij rasti të kryhet nga Kolegji, si organi i vetëm gjyqësor që vendos për vlerësimin përfundimtar në këtë proces.

**9.** Pas shqyrtimit gjyqësor të kryer në Kolegj, gjatë të cilit trupi gjykues pranoi disa akte të sjella nga subjekti i rivlerësimit në cilësinë e provës dhe dëgjoi palët, në bisedimet përfundimtare të zhvilluara në datën 13.05.2022, Komisionerja Publike Irena Nino kërkoi lënien në fuqi të vendimit objekt shqyrtimi për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, por duke i kërkuar Kolegjit ndryshimin e arsytimit dhe argumentimit ligjor.

**9.1.** Një arsyetim i ndryshëm, sipas Komisioneres, është ndihmesë lidhur me zbatimin e parimit të proporcionalitetit për të shqyrtuar nëse vendimi i Komisionit është në përputhje me standardet ekzistuese të arsyetuara në jurisprudencën e Kolegjit. Komisionerja potencoi faktin që ekzistenca e të ardhurave dhe e mënyrës së krijimit të tyre – nga biznesi – nuk vihet në dyshim, ato nuk mund të argumentohen se lidhen me subjektin e rivlerësimit, janë pasqyruar saktësisht në pasqyrat financiare dhe kanë lëvizur nëpërmjet rrugës bankare. Edhe në prezencë të ndonjë mangësie formale, veprimet e kryera nuk justifikojnë cenimin e vendimit objekt shqyrtimi apo vendosjen e masës disiplinore.

9.2. Konflikti i interesit, shkak i vetëm i mbetur i ankimit në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, sipas fjalës përfundimtare të Komisioneres Publike, është i pamjaftueshëm për ndryshimin e vendimit.

#### IV. Kundërshtimet e subjektit të rivlerësimit

10. Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në Kolegjin e Posaçëm të Apelit, (në vijim ‘Kolegji’), parashtrimet ndaj ankimit të Komisionerit Publik, më datë në datën 07.04.2022. Në argumentet e saj, subjekti i rivlerësimit u ndal në rrethanat kohore kur janë krijuar pasuritë nga personi i lidhur, që dëshmojnë se janë krijuar përpara se ajo të emërohej gjyqtare, në vlerësimin e saj për mënyrën sesi financimi i tyre nga personi i lidhur plotëson testin e ligjshmërisë së të ardhurave sipas nenit D të Kushtetutës dhe në veprimet e kryera prej saj në respekt të dispozitave të ligjit për të mënjauar konfliktin e interesit. Përfundimisht, subjekti kërkoi lënien në fuqi të vendimit nr.410, datë 30.06.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për konfirmimin e saj në detyrë.

10.1. Në mënyrë të përmbledhur, argumentet e parashtruara prej subjektit të rivlerësimit, znj. Atalanta Zeqiraj, sa u përket pasurive në përdorim të saj dhe në pronësi të babait – një apartament në Tiranë dhe një tjetër në Vlorë – paraqiten si më poshtë.

i.) Apartamenti në Tiranë<sup>2</sup> ka shërbyer për përdorim të përkohshëm prej saj, në kushtet kur nuk dispononte dhe nuk ka krijuar, deri më sot, asnjë pasuri të paluajtshme. Ky apartament është blerë në datën 12.09.2014, në kohën kur ajo [subjekti i rivlerësimit] kryente stazhin si gjyqtare, në pritje të emërimit. Pretendimi i Komisionerit për mungesë të ligjshmërisë së burimeve, nuk qëndron për këtë pasuri, sikurse edhe për apartamentin në Vlorë [referuar më poshtë], pasi nuk mund t’u atribuohet burimeve të krijuara prej saj.

ii.) Komisioni ka kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm, si të të ardhurave të babait, ashtu dhe të dokumentacionit ligjor dhe kontabël të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK për vitin 2014.

iii.) Apartamenti në Vlorë nuk përbën një pasuri që lidhet me detyrën e subjektit si gjyqtare dhe nuk ka të bëjë me ndonjë konflikt të mundshëm interesi. Pas përfundimit të stazhit, subjekti ka filluar të gjykojë çështje civile pa palë kundërshtare, me urdhër të kryetarit të Gjykatës Vlorë, datë 07.10.2015. Apartamenti është blerë me rezervë nga babai i subjektit më datë 06.10.2015, një ditë përpara se subjekti të përfshihej në shortin elektronik pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Është vërtetuar me prova shkresore se pagesa për blerjen e apartamentit është kryer nga llogaria personale e babait të subjektit të rivlerësimit, P. Z., pas transferimit të fondeve nga llogaria e shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK. Rezulton qartë se shoqëria ka dhënë borxh për ortakun e vetëm nëpërmjet sistemit bankar; ky veprim është regjistruar në pasqyrat financiare të shoqërisë për vitin 2015.

iv.) Pretendimi i Komisionerit se konfirmohet mundësia financiare e personit të lidhur, por jo ligjshmëria e burimeve të përdorura, është i pambështetur në provat e administruara nga Komisioni, i cili ka kryer hetim të thelluar për të ardhurat e babait, dokumentacionin ligjor dhe kontabël të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK. Ky hetim ka përfshirë analizën e të ardhurave të babait

---

<sup>2</sup> Në adresën: rruga “{\*\*\*}”, h. {\*\*\*}, ap. {\*\*\*}, Tiranë.

të subjektit si ortak dhe administrator i vetëm i shoqërisë. Gjatë procesit të hetimit administrativ në Komision, subjekti ka paraqitur raportin e ekspertit privat kontabël A. M., datë 14.06.2021, nga i cili rezulton se shoqëria “{\*\*\*}” ShPK ka pasur mundësi financiare të japë hua për ortakun e saj dhe ky veprim është pasqyruar në librat kontabël të shoqërisë dhe nuk ka sjellë asnjë shmangie nga detyrimet tatimore.

v.) Nga shkresa e Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier, rezulton se shoqëria nuk ka asnjë detyrim të prapambetur tatimor që mund të burojë nga marrëdhënia e huas. Për të provuar se shoqëria “{\*\*\*}” ShPK ka paguar rregullisht detyrimet tatimore që kanë lindur gjatë veprimtarisë së saj deri më 01.04.2022, subjekti ka paraqitur shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 01.04.2022.

vi.) Subjekti i rivlerësimit, znj. Atalanta Zeqiraj, e ka pasur këtë apartament në përdorim për periudhën tetor 2015 - korrik 2021<sup>3</sup>, gjatë së cilës ka qenë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë. Provat e paraqitura e bëjnë të pakundërshtueshëm faktin se apartamenti në Vlorë është në pronësi të babait, nuk lidhet me detyrën e saj si gjyqtare, është deklaruar si adresë banimi rregullisht, si dhe është paraqitur gjithë dokumentacioni që provon ligjshmërinë e krijimit të kësaj pasurie.

vii.) Apartamentet janë përdorur në periudha të caktuara. Vetë subjekti nuk është lidhur pazgjidhshmërisht me këto pasuri – aktualisht jeton me qira në Tiranë, në një apartament që *nuk* është në pronësi të të atit. Për të provuar këtë fakt, subjekti paraqiti në cilësinë e provës kontratën e qirasë së lidhur më datë 01.09.2021 [nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol.] për një apartament.

**10.2.** Lidhur me pretendimin e ngritur nga Komisioneri Publik, se nuk konfirmohet ligjshmëria e burimeve të përdorura për dhurimet në formën e shumave financiare nga babai i subjektit të rivlerësimit, në vlerat 5.000 euro, e përdorur për blerjen e automjetit në vitin 2014, dhe 200.000 lekë, subjekti parashtron se dhënia e këtyre shumave vërtetohet me deklaratën noteriale të datës 27.03.2015, lëshuar nga babai i subjektit dhe që më pas është bërë dokument shoqërues i deklaratës së pasurisë *vetting*. Është provuar që dy shumat janë tërhequr në formën e huas nga mjetet monetare të lira dhe të disponueshme të shoqërisë. Ky veprim është pasqyruar në librat kontabël të shoqërisë dhe nuk ka passjellë shmangie nga detyrimet tatimore.

**10.3.** Lidhur me shkakun e ankimit të Komisionerit, subjekti i rivlerësimit ka argumentuar se nuk gjendet në kushtet e *konfliktit të interesit*. Sapo ka marrë dijeni për situatën e konfliktit të interesit, konstatuar gjatë kontrollit nga ILDKPKI-ja, ajo ka marrë masa për ta zgjidhur sipas parashikimeve të nenit 37 të ligjit nr. 9367. Babai i subjektit, me kontratën e dhurimit të datës 27.5.2021, ka dhuruar kuotat prej 100% të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, te z. A. Z., që është vëllai i subjektit, por jo person i lidhur me të sipas nenit 24/1 të ligjit nr. 9367. Po ashtu, subjekti i rivlerësimit, znj. Atalanta Zeqiraj, theksoi se gjatë ushtrimit të detyrës, ka qenë e kujdesshme që të mos gjykojë çështje të cilat lidhen me interesa pasurorë të familjes. Në mënyrë të përmbledhur, në mbështetje të sa më sipër, subjekti parashtrroi sa vijon.

i.) ILDKPKI-ja, në raportin e dërguar në kuadër të procesit të rivlerësimit, ka konkluduar se subjekti nuk gjendet në kushtet e konfliktit të interesit.

---

<sup>3</sup> Nga kjo datë subjekti i rivlerësimit, znj. Atalanta Zeqiraj, ushtron funksionin si gjyqtare e deleguar në Gjykatën e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

ii.) Gjatë hetimit administrativ në Komision, subjekti ka paraqitur prova se nuk ka gjykuar në kushtet e konfliktit të interesit. Ka kërkuar informacion nga Agjencia e Prokurimit Publik nëse shoqëria “{\*\*\*}” ShPK ka lidhur kontrata me institucione publike në qytetin e Vlorës për periudhën tetor 2015 e në vijim. Në kushtet e mungesës së përgjigjes zyrtare për sa ka kërkuar, subjekti ka paraqitur në Komision listën e kontratave publike që ka lidhur shoqëria, për periudhën 2015-2021. Pasi ka marrë ankimin e Komisionerit, subjekti i është drejtuar sërish Agjencisë së Prokurimit Publik, e cila ka dërguar listën e kontratave publike për shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK, nga e cila rezulton se kjo shoqëri nuk ka lidhur kontrata publike me institucionet në qytetin e Vlorës<sup>4</sup>.

iii.) Masa administrative e gjobës, vendosur në ngarkim të saj nga ILDKPKI-ja me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 02.07.2021, për situatën e konstatuar në konflikt interesi, është kundërshtuar në rrugë gjyqësore nga subjekti i rivlerësimit. Në vijim, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka pranuar padinë e subjektit dhe ka ndryshuar vendimin e ILDKPKI-së [me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 07.03.2022].

**10.4.** Bashkëlidhur me parashtrimet, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit, shtatë (7) akte shkresore – cituar në vijim – të cilat u pranuan nga trupi gjykues në cilësinë e proves, konkretisht:

a. Dy shkresa nga Drejtoria Rajonale Tatimore Fier, përkatësisht shkresa e lëshuar në datën 01.04.2022, sipas së cilës vërtetohet se subjekti “{\*\*\*}” ShPK, deri më datë 01.04.2022, rezulton me 0 lekë (zero lekë) detyrime të papaguara dhe shkresa lëshuar më 06.04.2022, që pasqyron të dhëna për dividendin e shpërndarë nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, sipas së cilës konfirmohet se shoqëria nuk ka shpërndarë dividend në vitet 2013-2016.

b. Përgjigjja dhe shkresat përcjellëse lidhur me kërkesën për informacion të subjektit të rivlerësimit drejtuar kryetares së Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, së bashku me gjithë praktikën për ndryshimin e propozuar në ligjin nr. 9367/2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” nga një deputet në datën 06.07.2021.

c. Kthim përgjigjja drejtuar subjektit të rivlerësimit nga Agjencia e Prokurimit Publik më datë 28.03.2022, me anë të së cilës dërgohet lista e kontratave publike të lidhura nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, për periudhën 2015-2021.

ç. Përgjigjja e ILDKPKI-së, datë 04.04.2022, drejtuar subjektit të rivlerësimit për vënien në dispozicion të një kopjeje të shkresës së Agjencisë së Prokurimit Publik [nr. {\*\*\*}, datë 17.05.2021].

d. Vendimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, datë 02.07.2021, lidhur me padinë e subjektit të rivlerësimit kundër vendimit të Inspektorit të Përgjithshëm të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit të Pasurive që ka caktuar marrjen e masave administrative për shkelje të ligjit për konfliktin e interesave, dhe dënim me gjobë 100.000 lekë ndaj subjektit Atalanta Zeqiraj.

dh.) Kontrata noteriale e qirasë, lidhur më datë 01.09.2021, me anën e së cilës subjekti ka marrë me qira një apartament për banim në Tiranë.

---

<sup>4</sup> Me shkresën nr. {\*\*\*}, datë 28.03.2022.

## V. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

### A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit

#### A.I. Juridiksioni i Kolegjit

11. Bazuar në nenin 179/b, pikat 3, 4 dhe 5 të Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, që kanë për objekt rivlerësimin e subjekteve të rivlerësimit, me përjashtim të vendimeve për pezullim dhe detyrim për trajnim njëvjeçar<sup>5</sup>. Çështja në shqyrtim, që ka për objekt kundërshtimin e vendimit të Komisionit nga Komisioneri Publik, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit dhe shqyrtohet në seancë publike, nën dritën e nenit 65, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.
12. Nga aktet në fashikull, rezulton se ankimi i Komisionerit Publik është përcjellë në Kolegj më datë 11.10.2021, i shoqëruar me vendimin e Komisionit me nr. {\*\*\*} dhe datë 5.10.2021, me anën e të cilit është pranuar ankimi, me aktin e njoftimit të ankimit subjektiv të rivlerësimit, si dhe me dosjen e krijuar gjatë procesit të rivlerësimit në Komision. Shqyrtimi i çështjes në Kolegj kryhet sipas parashikimeve të nenit 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016<sup>6</sup>.

#### A.II. Mbi legjitimitimin e ankuesit

13. Komisioneri Publik, si përfaqësues i interesit publik në kryerjen e këtij procesi, legjitimohet *ratione personae* në ushtrimin e së drejtës së ankimit kundër vendimeve të Komisionit, në zbatim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neneve C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016. Komisioneri Publik legjitimohet *ratione temporis* pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

#### A.III. Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

14. Në përputhje me nenin 65, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga Komisioneri Publik, kryhet në seancë publike. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, për të cilën Kolegji u vu në lëvizje nëpërmjet ankimit të Komisionerit, u mor në shqyrtim në seanca gjyqësore publike, të zhvilluara në prani të palëve.
15. Në kuadër të veprimeve përgatitore të çështjes, janë ftuar palët në proces, subjekti i rivlerësimit dhe Komisioneri, që të depozitojnë në Kolegj parashtrimet së bashku me aktet që kërkojnë të merren në cilësinë e provës në gjykim, në mënyrë që këto parashtrime dhe akte t'u

---

<sup>5</sup> Parashikuar nga neni E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës.

<sup>6</sup>Neni 65, pika 1 parashikon: "1. Procesi gjyqësor në Kolegjin e Apelimit kryhet në përputhje me rregullat e parashikuara në nenet 47, 48, pika 1; 49, 51 dhe 55 të ligjit nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative [...]".



komunikohen reciprokisht palëve në proces. Gjithashtu, subjektit të rivlerësimit i është vënë në dispozicion peticioni i disa avokatëve nga Vlora, përcjellë në Kolegj nga Komisioneri Publik me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 04.04.2022.

16. Gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes dhe pasi u njoh me kërkesën e subjektit të rivlerësimit për riçeljen e hetimit gjyqësor dhe administrimin e provave të reja, në vijim të parashtrimeve të depozituara me shkrim, trupi gjykues i Kolegjit vendosi të çelë hetimin gjyqësor dhe të administrojë në cilësinë e provës aktet shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit nën dritën e dispozitave të nenit F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 45 dhe 49 të ligjit nr. 84/2016.

*B. Mbi shkaqet e ankimit*

*B.I. Ligjshmëria e të ardhurave të personit të lidhur për blerjen e dy apartamenteve*

17. Për sa i përket apartamentit në Vlorë, deklaruar në përdorim nga subjekti i rivlerësimit, znj. Atalanta Zeqiraj, në deklaratën e pasurisë *vetting*, dhe në pronësi të babait të saj, Komisioni ka konkluduar se nuk mund të argumentohet mungesë e të ardhurave të ligjshme për blerjen e pasurisë. Ky konkluzion i Komisionit mori në konsideratë disa aspekte që lidhen me aktivitetin e shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, në pronësi dhe administrim të babait të subjektit të rivlerësimit, sikurse shumat e konsiderueshme të qarkullimit vjetor dhe mjeteve monetare të lira, shlyerjen e rregullt të detyrimeve tatimore dhe që vlera e paguar, si dhe transfertat, pjesë e transaksionit të blerjes, janë dokumentuar plotësisht dhe kryer në të njëjtën ditë – siç rezulton nga transaksionet bankare. Të gjitha fondet, sikurse ka konstatuar Komisioni, kanë për origjinë një llogari bankare të shoqërisë të çelur përpara se të bëhej pagesa. Komisioni po ashtu mori në konsideratë edhe faktin që personi i lidhur, z. P. Z., nuk ka qenë asnjëherë subjekt deklarues.

17.1. Komisioni ka konkluduar që subjekti nuk ndodhej në kushtet e deklarimit të dyfishit të pasurisë së ligjshme, përfshirë edhe personat e lidhur me të, dhe as në kushtet e deklarimit të pamjaftueshëm – parashikuar në pikat 1 dhe 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016. Ky konkluzion u referohet parimeve të objektivitetit dhe të proporcionalitetit, fakteve e provave, si periudhës së përdorimit të pasurisë nga subjekti, datës së fillimit të detyrës së saj si gjyqtare, burimit të krijimit të pasurisë, vlerave dhe mundësisë financiare të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, faktit që çdo veprim është kryer nga babai i subjektit si përfaqësues ligjor i shoqërisë, dhe jo nga subjekti, mungesës së indiceve për lidhje të subjektit me pronësinë e kësaj pasurie, si dhe shpjegimeve të subjektit.

17.2. Për sa i përket apartamentit në Tiranë, në përdorim të subjektit të rivlerësimit, znj. Atalanta Zeqiraj, në periudhën kohore 2014-2015 dhe në pronësi të babait të saj, ashtu si edhe për apartamentin në Vlorë, Komisioni ka konkluduar se nuk ka dyshime për rrethanat e blerjes, sikurse edhe mungon çdo lidhje e subjektit të rivlerësimit me këtë pasuri. Po ashtu, Komisioni ka theksuar se analiza e provave shkresore dhe e deklarimeve të subjektit përjashton arritjen në konkluzion të mungesës “së të ardhurave të ligjshme për blerjen e pasurisë” apo që këto të ardhura të kenë qenë të subjektit të rivlerësimit. Në këtë vlerësim, Komisioni ka arritur mbi bazën e fakteve, si koha e blerjes së apartamentit përpara se subjekti të ushtronte detyrën, deklarimi rregullisht i pasurisë si adresë banimi, reflektimi në librat kontabël përkatës i huas së dhënë nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, ortakut të vetëm P. Z., fakti që të gjitha veprimet janë kryer

në rrugë bankare si nga ana e shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, si person juridik, ashtu edhe nga ana e administratorit të saj, si individ dhe, së fundmi, qarkullimi dhe mjetet e lira monetare në vlera të konsiderueshme të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK.

**17.3.** Pasi analizoi aktet e fashikullit të përcjellë nga Komisioni, dëgjoi Komisionerin Publik, dëgjoi subjektin e rivlerësimit dhe analizoi aktet e sjella prej subjektit, nën dritën e dispozitave të ligjit nr. 84/2016 dhe rregullimeve të tjera ligjore që gjejnë zbatim në rrethanat konkrete, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se prapësimet e subjektit të rivlerësimit janë të bazuara. Trupi gjykues po ashtu ndan të njëjtin qëndrim me atë të parashtruar nga Komisionerja Publike në bisedimet përfundimtare. Ky konkluzion bazohet në aspektet e kontrollit të ushtruar nga Kolegji, që shtjellohen në detaj në vijim.

**17.4.** Së pari, nga aktet në fashikull, rezulton se konkluzionet e nxjerra nga Komisioni për rrethanat faktike që kanë passjellë blerjen e dy apartamenteve në përdorim të subjektit të rivlerësimit, znj. Atalanta Zeqiraj, nga babai i saj, qëndrojnë. Po ashtu, aktet në fashikull konfirmojnë edhe aspektet e konkluzionit të Komisionit, që referon veprimet e kryera nëpërmjet sistemit bankar nga babai i subjektit të rivlerësimit, në funksion të krijimit të këtyre dy pasurive, si në vijim.

a. Më datë 12.09.2014, babai i subjektit të rivlerësimit, z. P. Z., ka blerë një apartament në Tiranë<sup>7</sup>, në vlerën 50.000 euro. Në të njëjtën datë, rezulton që nga llogaria e shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, ka kaluar shuma prej 50.000 eurosh në llogarinë bankare të ortakut të vetëm të kësaj shoqërie, babait të subjektit, z. P. Z. Transaksioni i mësipërm bankar që ka paraprirë blerjen, është kryer si hua nga shoqëria tek ortaku i vetëm. Në vitin 2014 nuk rezulton që shoqëria të ketë shpërndarë dividend. Në pyetësorin e drejtuar gjatë hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar përdorimin e këtij apartamenti pa kundërshtim, në periudhën kohore shtator 2014 - tetor 2015.

b. Më 6.10.2015, babai i subjektit të rivlerësimit ka blerë apartament në Vlorë<sup>8</sup>, në vlerën 3.800.000 lekë. Në të njëjtën datë, rezulton që nga llogaria e shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK ka kaluar shuma prej 3.800.000 lekësh në llogarinë bankare të ortakut të shoqërisë, z. P. Z., babait të subjektit të rivlerësimit, me përshkrimin “dhënie huaje”. Transaksioni i mësipërm bankar, që ka paraprirë blerjen, është kontabilizuar nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK si hua e dhënë nga shoqëria tek ortaku i vetëm. Në vitin 2015 nuk rezulton që shoqëria të ketë shpërndarë dividend.

**17.5.** Nga analiza financiare e kryer në Komision dhe në Kolegj, rezulton se në vitet përkatëse, 2014 dhe 2015, shoqëria “{\*\*\*}” ShPK ka pasur xhiro në vlera të konsiderueshme dhe gjendje në llogaritë bankare po ashtu të mjaftueshme për të mbuluar veprimet e kryera<sup>9</sup>. Nga aktet e përcjella nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, rezulton po ashtu që personi juridik në pronësi të babait të subjektit të rivlerësimit dhe në administrim të tij, ka shlyer

<sup>7</sup> Apartamenti ndodhet në rrugën “{\*\*\*}”, me nr. {\*\*\*}, zona kadastrale {\*\*\*}, Tiranë, me sipërfaqe 45 m<sup>2</sup>. Pagesa, kryer nëpërmjet derdhjes në llogarinë e noterit dhe më 04.11.2015, kaluar në llogarinë e shitëses. Kontrata noteriale mban nr. {\*\*\*}.

<sup>8</sup> Apartamenti ndodhet në lagjen “{\*\*\*}”, rruga “{\*\*\*}”, kompleksi {\*\*\*}, kulla {\*\*\*}, k. {\*\*\*}.

<sup>9</sup> Sipas vendimit të Komisionit, xhiroja në vitin 2014, ishte 62.857.603 lekë [faqe 18], ndërsa në vitin 2015, në vlerën 71.633.639 lekë [faqe 9]. Sipas shkresës nr. {\*\*\*}, dt.14.05.2020, nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, xhiroja e deklaruar e “{\*\*\*}” ShPK, në vitin 2014 ishte 62.995.103 lekë, ndërsa në vitin 2015 në vlerën 71.633.639 lekë.

detyrimet tatimore që lidhen me aktivitetin privat. Së fundmi, nga aktet e e shoqërisë<sup>10</sup>, rezulton se ortaku i vetëm [babai i subjektit të rivlerësimit] nuk ka përfituar dividendë për vitet 2014 - 2015 dhe, si rrjedhim, për këtë periudhë, nuk ka pasur detyrimin për të paguar detyrimet tatimore për fitimin e shpërndarë, sipas legjislacionit për tatimin mbi të ardhurat personale, të lexuar së bashku me parashikimet e nenit 76<sup>11</sup> të ligjit nr. 9901/2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare". Për pasojë, këto të ardhura rezultojnë të plotësojnë testin e ligjshmërisë së parashikuar nga neni D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe neni 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016<sup>12</sup>.

**17.6.** Nga ana tjetër, trupi gjykues i Kolegjit vëren se një analizë e thelluar e kuadrit ligjor që normon funksionimin e shoqërive tregtare, e konkretisht ligji nr. 9901/2008 tregon që huadhënia nga shoqëria ortakut të vetëm, që është njëkohësisht edhe administrator, bie ndesh me parashikimet e ligjit që kanë për qëllim shmangien e konfliktit të interesit në veprimtarinë ekonomike private. Neni 13, pika 7 e ligjit nr. 9901/2008 parashikon që:

*[...] Një person, i cili është njëkohësisht administrator dhe ortak [...] i vetëm i shoqërisë, nuk mund të lidhë kontrata huaje apo garancie me shoqërinë [...]. Mospërmbushja e këtij detyrimi përbën kundërvajtje administrative dhe administratori dënohet me gjobë deri në 15.000 lekë [...].*

**17.7.** Në vijim të sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vëren se ndonëse fondet e përdorura nga personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit, babai i saj, rezultuan të jenë krijuar me të ardhura të ligjshme, nën dritën e kuadrit ligjor të sipërcituar, veprimet financiare të kryera prej personit të lidhur bien ndesh me dispozitat që rregullojnë veprimtarinë e shoqërive tregtare, në funksion të shmangies së konfliktit të interesit. Për rrjedhojë, deduktohet që ndërsa shoqëria nuk ka pasur detyrimin ligjor që të shpërndante dividend, në kushtet kur babait të subjektit të rivlerësimit nuk i lejohej, si administrator dhe ortak i vetëm i shoqërisë, të merrte hua nga shoqëria, mënyra e vetme për të tërhequr fonde do të ishte shpërndarja e dividendit dhe pagesa e tatimeve përkatëse.

**17.8.** Në përmbledhje, trupi gjykues vëren që kjo shkelje administrative, në kushtet e konfliktit të interesit në aktivitetin privat, e kryer nga personi i lidhur, në kushtet dhe rrethanat konkrete, nuk mund të argumentohet se përlligj zbatimin e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit e do të ishte disproporcionale në raport me qëllimin për të cilin është ndërtuar procesi i rivlerësimit. Ky konkluzion, përpos faktit që shkelja *nuk* përbën

---

<sup>10</sup> Nga vendimet e Asamblesë së ortakëve të shoqërisë, për periudhën 2014-2015, që ndodhen bashkëlidhur shkresës të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve me nr. {\*\*\*}, datë 14.05.2020, rezulton se për vitet 2014, 2015, fitimi i shoqërisë është përdorur për investime dhe nuk është shpërndarë si dividend. Kjo situatë paraqitet e ndryshme nga vitet financiare 2016 dhe 2018, në të cilat me vendimet e asamblesë së ortakëve të shoqërisë, të datave 4.1.2017 dhe 23.05.2019, është vendosur shpërndarja e dividendit dhe është kryer pagesa e tatimit përkatës.

<sup>11</sup> Neni 76 pika 1 i ligjit 9901/2008 përcakton që "Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në statut, ortakët kanë të drejtë të ndajnë pjesën e fitimit të deklaruar në pasqyrat financiare të shoqërisë [...]"

<sup>12</sup> Dy dispozitat përcaktojnë respektivisht: që "[...] Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore. Elemente të tjera të pasurisë së ligjshme përcaktohen me ligj.[...]" dhe "[...] "Të ardhura të ligjshme" janë të ardhurat e subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur të tij/saj, sipas përcaktimeve të burimit të të ardhurave, të parashikuara në ligjin "Mbi tatimin mbi të ardhurat"[...]"

veprime të kryera nga vetë subjekti dhe është kundërvajtje administrative që i ngarkohet personit përgjegjës – babait të subjektit të rivlerësimit – dhe që veprimi rezulton të jetë pasqyruar në regjistrat kontabël të shoqërisë, që teorikisht lejon kontrollin e administratës tatimore, sikurse edhe shlyerjen e detyrimeve tatimore në një kohë të dytë, merr në konsideratë dhe faktin që gjithë këto veprime kanë ndodhur përpara se subjekti të emërohej në detyrë. Ky aspekt i fundit përjashton mundësinë teorike të lidhjes së fondeve me përfitime financiare, të cilat nuk mund të justifikohen ligjërisht nga puna e subjektit të rivlerësimit. Po ashtu, trupi gjykues vëren që në periudhën e ndërmjetme nga vendimi objekt shqyrtimi dhe përpara ankimit të ushtruar nga Komisioneri që mban datën 30.09.2021, subjekti i rivlerësimit, znj. Atalanta Zeqiraj, ka ndërmarrë hapa për të ndërprerë ndërthurjen e interesave të saj nga aktiviteti ekonomik i të atit, edhe nëpërmjet jetesës me qira në një apartament tjetër, që nga data 21.09.2021, për shkak të komandimit në Gjykatën e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar [shih edhe paragrafin 10.4/dh më sipër].

## *B.II. Ligjshmëria e të ardhurave për blerjen e automjetit dhe dhurimin e shumave në vlerën 200.000 lekë*

18. Nga aktet në fashikull, rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting* një automjet me burim një dhuratë monetare në vlerën 5.000 euro, nga babai i subjektit të rivlerësimit në vitin 2014 dhe dhurime monetare në vlerën 200.000 lekë, po në vitin 2014, nga i njëjti burim. Komisioneri Publik parashtroi se, ndonëse konfirmohet mundësia financiare për dhuratat monetare në vlerat përkatëse, nuk u konfirmua ligjshmëria e burimeve të përdorura. Së bashku me situatat e tjera faktike të shtjelluara më sipër dhe në vijim, ky kërkim i Komisionerit i është paraqitur fillimisht për kontroll Kolegjit për të shqyrtuar nëse vendimi objekt shqyrtimi i Komisionit dhe konfirmimi në detyrë i subjektit, është në përputhje me kërkesat e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës.

18.1. Në vendimin objekt shqyrtimi, sikurse edhe në lidhje me transaksionet financiare që kanë paraprirë blerjen e pasurive në përdorim, shtjelluar më sipër, Komisioni ka konkluduar se nuk ka konstatuar problematika në lidhje me shumën prej 5.000 eurosh të dhuruar subjektit të rivlerësimit, znj. Atalanta Zeqiraj, nga babai, pasi rezulton e krijuar me burime të ligjshme dhe është kryer përpara emërimit të saj si gjyqtare<sup>13</sup>. Po ashtu, pas analizës financiare të kryer, Komisioni konstatoi se babai dhe nëna e subjektit të rivlerësimit kanë pasur mundësi financiare për të dhuruar shumën prej 200.000 lekësh në vitin 2014, dhe që deklarimi i këtij fakti nga ana e subjektit në deklaratën e pasurisë *vetting*, ishte i saktë<sup>14</sup>. Në analizën financiare, Komisioni ka përlllogaritur të ardhurat e babait të subjektit si administrator i shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, për të cilat rezulton se janë paguar detyrimet tatimore – përfshirë dhe kontributet e sigurimeve shëndetësore dhe shoqërore, sikurse edhe tatimin mbi të ardhurat personale.

18.2. Gjatë hetimit administrativ të kryer, Komisioni ka konstatuar se, sikurse edhe pasuritë e shtjelluara më sipër, burimi i krijimit të pasurisë automjet është marrë në formë huaje nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, në vitin 2014. Siç është referuar edhe më sipër, shoqëria nuk ka shpërndarë dividend në vitin 2014, që nënkupton se fondet nuk kanë prejardhje nga shpërndarja e fitimit të shoqërisë. Pas

<sup>13</sup> Faqe 15 dhe 16 e vendimit të Komisionit.

<sup>14</sup> Faqe 22 dhe 23 e vendimit të Komisionit.

shpjegimeve të subjektit dhe analizës së provave, Komisioni konkludoi që kontabilizimi i huas dhënë ortakut nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, *përbën një pasqyrim të saktë të realitetit dhe situatës financiare* dhe, si i tillë, nuk ka sjellë dhe as nuk mund të sjellë shmangie të detyrimeve tatimore.

**18.3.** Siç është përmbledhur në paragrafin 10.2 më sipër, dhe pa e përsëritur atë, subjekti i rivlerësimit në prapësim të shkaqeve të ankimit të Komisionerit për këto aspekte të kontrollit të pasurisë, referoi deklaratën noteriale të datës 27.03.2015, lëshuar nga babai i subjektit për të dokumentuar dhënien e këtyre shumave. Kjo deklaratë është hartuar përreth dy vite përpara se të plotësohej deklarata e pasurisë *vetting*, e më pas është bërë dokument shoqërues i saj [deklaratës së pasurisë]. Po ashtu, subjekti referoi edhe faktin që dy shumat janë tërhequr në formën e huas nga mjetet monetare të lira dhe të disponueshme të shoqërisë dhe veprimet nuk kanë passjellë shmangie nga detyrimet tatimore. Në mbështetje të këtyre argumentave, subjekti solli në vëmendje akte të administruara në fashikull që përbëhen nga konfermat bankare të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK.

**18.4.** Në vlerësim të pretendimeve të Komisionerit gjatë procesit gjyqësor në Kolegj, dhe kërkimit të tij përfundimtar, pretendimeve të subjektit të rivlerësimit dhe akteve në fashikuj e atyre të pranuar në cilësinë e provës, sjellë nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues i Kolegjit vlerësoi se konkluzioni i Komisionit për *mjaftueshmërinë e burimeve të ligjshme* që kanë shërbyer për të financuar këto dhurime, është i bazuar. Nga ana tjetër, sikurse është theksuar edhe më sipër në lidhje me veprimet e kryera nga babai i subjektit të rivlerësimit për krijimin e pasurive të paluajtshme, që më pas i janë dhënë në përdorim subjektit të rivlerësimit në vitet 2014-2017, marrja hua nga shoqëria në kushtet faktike konkrete, bie ndesh me përcaktimet e nenit 13, pika 7 e ligjit nr. 9901/2008 për shmangien e konfliktit të interesit në ushtrimin e aktivitetit privat tregtar, dhe përbën kundërvajtje administrative.

**18.5.** Në vijim të sa është shtjelluar më sipër, edhe për këtë aspekt të vlerësimit të kriterit pasuror, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se veprimet e babait të subjektit të rivlerësimit, për të gjitha arsyet e shtjelluara në paragrafët 17.7 dhe 17.8, nuk mund të passjellin masën disiplinore të shkarkimit nga detyra për subjektin e rivlerësimit. Një masë e tillë do të ishte joproportionale dhe do të tejkalonte qëllimet për të cilat është ngritur sistemi i rivlerësimit.

**18.6.** Së fundmi, vlerësimi i mësipërm gjen zbatim edhe për vlerën prej 200.000 lekësh, dhuruar subjektit nga babai. Komisioneri Publik parashtrroi si shkak ankimi vetëm ligjshmërinë e burimeve financiare të prindërve të subjektit të rivlerësimit, duke mos kontestuar mjaftueshmërinë e krijimit të tyre, si dhe analizën financiare të pasqyruar në vendimin e Komisionit. Konkretisht, nga analiza e referuar në vendimin e Komisionit [faqet 22 dhe 23], rezulton që prindërit e subjektit të rivlerësimit kanë pasur mundësi t’i dhuronin subjektit të rivlerësimit shumën përkatëse<sup>15</sup>. Në këtë pjesë të arsyetimit, konkretisht në paragrafët 7.11 – 7.16, Komisioni qartazi ka referuar edhe hetimet e kryera për ligjshmërinë e burimeve, bazuar në të ardhurat, kontributet e derdhura dhe tatimin mbi të ardhurat personale për vitet 2012-2014 dhe shpenzimet e jetesës të përllogaritura. Për rrjedhojë, në kushtet kur është hetuar edhe për ligjshmërinë dhe janë specifikuar zërat përkatës në vendim, konkluzioni i Komisionit për këtë aspekt, qëndron.

---

<sup>15</sup> Bilanci familjar për atë vit, sipas analizës së Komisionit, rezulton në vlerën pozitive prej 451.000 lekësh.

### *B.III. Lidhur me konfliktin e interesit*

19. Në ankim, Komisioneri ka parashtruar se vlerësimi dhe arsyetimi i Komisionit për sa i përket gjendjes së konfliktit të interesit, nuk është i plotë, pasi është fokusuar në vlerësimin e kësaj gjendjeje në raport me kriterin e pasurisë, dhe jo si pjesë e një vlerësimi tërësor të çështjes apo dhe në këndvështrim të kontrollit të kriterit të aftësive profesionale. Subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti shpjegime dhe prova lidhur me konfliktin e interesit, të cilat mund të ndihmonin në përcaktimin e origjinës dhe fushëveprimit të këtij konflikti të pretenduar.

19.1. Gjatë hetimit administrativ, Komisioni ka konstatuar që shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, ku babai i subjektit është ortak i vetëm, ka përfituar fonde publike nga buxheti i shtetit, për periudhën 2014-2018, për shkak të pjesëmarrjes në prokurime të ndryshme publike. Bazuar në nenet 21 dhe 24 të ligjit nr. 9367, duke filluar nga data 3.6.2014 – me ndryshimet ligjore të sjella nga ligji nr. 44/2014 – subjekti ishte në shkelje detyrimeve të saj sipas këtij ligji. Në përfundim të procesit, Komisioni ka konkluduar që qenia e babait të subjektit të rivlerësimit në kushtet e konfliktit të interesit, sipas parashikimit të pikës 1 të nenit 24 të ligjit nr. 9367, si dhe të ligjit nr. 44, datë 24.4.2014, nuk mund të kualifikojë subjektin e rivlerësimit në kushtet e pamjaftueshmërisë në deklarinimin e kriterit pasuror, sipas parashikimit të pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016 dhe të përbëjë shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit të subjektit të rivlerësimit nga detyra.

19.2. Një panoramë e plotë e prapësimeve të subjektit të rivlerësimit për këtë shkak ankimi, është shtjelluar në paragrafin 10.3 e nënpjesët e tij më sipër. Pa përsëritur sa më sipër, në thelb këto argumente konsistojnë në faktin që subjekti i rivlerësimit, znj. Atalanta Zeqiraj, nuk e ka ndërthurur detyrën me marrëdhëniet e krijuara për shkak të kontratave publike të lidhura nga babai si administrator i shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK dhe, për rrjedhojë, aktiviteti i tij privat nuk ka sjellë pasoja në ushtrimin e përgjegjësisë së saj profesionale. Subjekti argumentoi se janë marrë gjithë masat e nevojshme, sapo ka marrë dijeni për ekzistencën e konfliktit të interesit nga ILDKPKI-ja, për ta shmangur atë në të ardhmen. Subjekti theksoi se personalisht nuk ka qenë në situatën e konfliktit të interesit, parë nën dritën e dispozitave të ligjit nr. 9367/2005, pasi nuk ka zhvilluar asnjë gjykim me palë institucionet me të cilat babai i saj ka lidhur kontrata publike, çka mund të krijonte konfliktin “në dukje të interesit”.

19.3. Në mbështetje të këtyre argumenteve, subjekti i rivlerësimit paraqiti në Kolegj, në cilësinë e provës, 5 (pesë) akte, të cituara në paragrafin 10/4/b e në vijim më sipër, të cilat u pranuan dhe administruan me cilësinë e provës në gjykim. Analiza e tyre është pjesë integrale e arsyetimit të kryer nga trupi gjykues në Kolegj.

19.4. Pasi analizoi kërkimet e Komisionerit Publik në ankim dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor, pretendimet e subjektit të rivlerësimit dhe aktet në fashikull, trupi gjykues i Kolegjit konkludoi se subjekti i rivlerësimit ka qenë në kushtet e konfliktit të interesit në periudhën kohore nga viti 2014 deri në vitin 2021, për shkak të kontratave të lidhura nga shoqëria tregtare, pronar i vetëm dhe administrator i së cilës është babai i subjektit të rivlerësimit. Pavarësisht nga ky konstatim, në rrethanat konkrete, faktet që rezultuan nga analiza e kryer në Kolegj, nuk mund të passjellin zbatimin e masës disiplinore të shkarkimit për subjektin e rivlerësimit, në kuptim të ligjit nr.

84/2016. Pretendimet e Komisioneres Publike në vlerësimin e parashtruar në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, janë të bazuara.

**19.5.** Konkluzioni i mësipërm merr në konsideratë sa konfirmuan aktet e administruara në analizë të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit. Subjekti i rivlerësimit, znj. Atalanta Zeqiraj, ka deklaruar se ka marrë njoftim për herë të parë për konfliktin e interesit në datën 20.5.2021, nga ILDKPKI-ja. Në analizë të akteve dhe veprimeve të ndërmarra prej saj, dokumentuar edhe në vijim, rezulton që subjekti i rivlerësimit ka kryer një sërë veprimesh për të verifikuar dhe shëruar gjendjen e konfliktit të interesit, si në lidhje me pasuritë që ka pasur në përdorim dhe në pronësi (automjeti), ashtu dhe për shkak të aktivitetit që ushtronte i ati.

**19.6.** Konkretisht, nga dokumentacioni i administruar në fashikull, rezulton se me kontratën e dhurimit të datës 27.5.2021, babai i subjektit, z. P. Z., pas 25 vitesh veprimtarie, i ka dhuruar 100% të kuotave të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, z. A. Z. – vëllai i subjektit. Nën dritën e përcaktimeve të nenit 24, paragrafi i parë i ligjit nr. 9367, vëllai i subjektit të rivlerësimit nuk është person i lidhur me zyrtarin<sup>16</sup>. Dhurimi i kuotave dokumentohet edhe nga vendimi i asamblesë së shoqërisë për dhënien e pëlqimit për dhurimin, nga vendimi për miratimin e dorëheqjes së administratorit, z. P. Z., nga dokumentacioni i aplikimit për ndryshime në të dhënat e regjistrimit të shoqërisë, si dhe nga ekstrakti i Qendrës Kombëtare të Biznesit për shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK, ku pasqyrohet se ortak i vetëm dhe administrator është z. A. Z. Të gjitha këto akte janë sjellë nga subjekti në cilësinë e provës në procesin e hetimit administrativ të kryer nga Komisioni.

**19.7.** Gjithashtu, nga dokumentacioni i paraqitur në Komision, subjekti ka provuar nëpërmjet akteve se nuk ka dhënë vendime në kushtet e konfliktit të interesit. Këto akte shkresore nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë provojnë se personi juridik në pronësi dhe administrim të të atit, sikurse edhe shitësit e apartamentit në përdorim të saj në Vlorë apo në Tiranë, si dhe shitësit e automjetit në pronësi të bashkëjetuesit, nuk kanë pasur procese gjyqësore në këto gjykata për periudhën gjatë së cilës subjekti i rivlerësimit, znj. Atalanta Zeqiraj, ka ushtruar funksionin si gjyqtare<sup>17</sup>.

**19.8** Po ashtu, Agjencia e Prokurimit Publik ka njoftuar ILDKPKI-në<sup>18</sup> që subjekti “{\*\*\*}” ShPK ka fituar në prokurime publike, për periudhën nga 01.01.2017 deri në 31.12.2020, kontrata publike, sipas një liste të përditësuar [datë 28.03.2022, cituar më sipër në paragrafin 10.4/c], sjellë nga subjekti dhe pranuar në Kolegj në cilësinë e provës, sipas së cilës asnjë prej kontratave publike për shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK nuk përfshin institucione në qytetin e Vlorës. Për të mbështetur të njëjtin argument – që ajo vetë nuk ka dhënë vendime në kushtet e konfliktit të interesit brenda sferës territoriale ku ajo ushtronte detyrën në periudhën kohore në fjalë – subjekti i rivlerësimit ka sjellë në Kolegj edhe projektndryshimet e propozuara në ligjin nr. 9367, të paraqitura në Kuvend. Këto ndryshime që kanë rezultuar të pasuksesshme për

---

<sup>16</sup> Sipas nenit 24, pika 1 e ligjit 9367/2005, rrethi i personave të lidhur me zyrtarin, në zbatim të ndalimeve të përcaktuara në nenin 21 dhe në nenin 22 të ligjit, nuk përfshin vëllezërit ose motrat e zyrtarëve dhe përbëhet nga bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, fëmijët në moshë madhore dhe prindërit e zyrtarit e të bashkëshortit/es dhe bashkëjetuesit/es.

<sup>17</sup> Shkresat nr. {\*\*\*}, datë 18.06.2021, nr. {\*\*\*} dhe nr. {\*\*\*}, datë 16.06.2021, respektivisht nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Vlorë, në përgjigje të kërkesave të subjektit të rivlerësimit, lidhur me çështje gjyqësore me palë shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK, individët E. J. dhe A. K. – shitësit e apartamentit në Vlorë, L. N., shitëse e apartamentit në Tiranë, si dhe A. J., shitësi i automjeti.

<sup>18</sup> Përgjigje zyrtare e datës 19.05.2020.

momentin, synojnë të ilustrojnë trendin legjislativ që teorikisht do ta ngushtonte gamën e kontrollit brenda juridiksionit gjeografik të gjykatave apo njërive administrative ku funksionarët publikë ushtrojnë detyrën e tyre.

**19.9** Së fundmi, subjekti i rivlerësimit i është drejtuar gjykatës dhe ka fituar padinë për të rrëzuar vendimin e Inspektoratit të Lartë të ILDKPKI-së që ka disponuar me gjobë për të dhe ka konstatuar se ajo gjendet në kushtet e konfliktit të interesit [cituar më sipër në paragrafin 10.4/d]. Sipas vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, datë 02.07.2021, detyrimin për të shmangur konfliktin e interesit, e ka personi i lidhur me zyrtarin dhe, për pasojë, gjoba e vendosur duhet t'i ngarkohet babait të subjektit të rivlerësimit.

**19.10** Duke abstraguuar nga vendimi gjyqësor i sipërcituar dhe fakti që ligji nr. 9367 ka fushë veprimi vetëm funksionarët publikë dhe nëpërmjet tyre, personat e njësuar me ta, dhe ndalon shprehimisht kontratat publike, trupi gjykues i Kolegjit çmon se veprimet e ndërmarra nga subjekti i rivlerësimit, pasi mori njoftim për gjendjen e konfliktit të interesit, kanë qenë gjithëpërfshirëse dhe krijojnë bindjen se kanë plotësuar gjithë nevojat për shmangien e këtij konflikti në të ardhmen.

**19.11** Ndonëse qëndron përgjegjësia e subjektit të rivlerësimit që të identifikonte këto aspekte, trupi gjykues vëren dhe njëherazi vlerëson se ka disa aspekte faktike, të cilat çojnë në konkluzionin se konflikti i interesit i konstatuar nuk mund të përbëjë shkelje nën dritën e ligjit nr. 84/2016 dhe as të sjellë pasojën e shkarkimit në procesin e rivlerësimit, si në drejtim të kriterit të vlerësimit të pasurisë, për sa kohë nuk rezulton se subjekti ka krijuar ndonjë pasuri për shkak të kësaj gjendjeje, ashtu edhe në drejtim të kriterit të vlerësimit të aftësisë profesionale, për sa kohë që subjekti nuk rezulton të ketë gjykuar ndonjë çështje në kushtet e konfliktit të interesit. Në këtë konsideratë, trupi gjykues pati parasysh ndër të tjera: shkëputjen gjeografike të subjektit të rivlerësimit, znj. Atalanta Zeqiraj, nga prindërit për shkak të shkollës, veprimet e menjëhershme të kryera që tregojnë gatishmërinë e saj dhe të personave të lidhur në kuptim të ligjit nr. 9367/2005 për të përmbushur ligjin dhe mbështetur subjektin me përgjegjësi dhe përkushtim në kryerjen e detyrës prej saj, faktin që nuk rezulton që babai të ketë pasur kontrata publike në zonën e kompetencës territoriale të gjykatës ku subjekti ushtronte detyrën, faktin që subjekti i rivlerësimit duket se ka ndërmarrë hapa që të shkëpusë edhe interesat e saj financiarë nga prindërit dhe që subjekti i rivlerësimit nuk rezulton të ketë krijuar të ardhura, pasuri apo përfitime si pasojë e situatës së konfliktit të interesit.

- 20.** Në përfundim, trupi gjykues i Kolegjit, pasi analizoi pretendimet e ngritura nga Komisioneri Publik në ankim dhe në parashtrime, parashtrimet e subjektit të rivlerësimit gjatë seancave gjyqësore publike, pasi shqyrtoi provat shkresore të administruara në dosjen gjyqësore të kësaj çështjeje, si dhe pasi dëgjoi konkluzionet përfundimtare të Komisionerit dhe kërkimet e subjektit të rivlerësimit, vlerëson se vendimi i Komisionit është mbështetur në një vlerësim të drejtë të fakteve që kanë rezultuar nga hetimi administrativ dhe gjyqësor për vlerësimin e pasurisë, si dhe në legjislacionin e zbatueshëm.
- 21.** Për sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit çmon se vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 410, datë 30.06.2021, i cili ka vendosur konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Atalanta Zeqiraj, është i drejtë dhe i bazuar në ligj dhe, për pasojë, duhet të lihet në fuqi.



## **PËR KËTO ARSYE,**

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

### **VENDOSI:**

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 410, datë 30.06.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Atalanta Zeqiraj.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 16.05.2022.

#### **ANËTARE**

**Albana SHTYLLA**

*nënshkrimi*

#### **ANËTARE**

**Ina RAMA**

*nënshkrimi*

#### **ANËTARE**

**Mimoza TASI**

*nënshkrimi*

#### **RELATORE**

**Rezarta SCHUETZ**

*nënshkrimi*

#### **KRYESUES**

**Sokol ÇOMO**

*nënshkrimi*